

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE SHTATOR-DHJETOR 2023

Nr. rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesës	Tarifa
1/ e-mail	03.10.2023	Kërkesë për informacione historike, narrative për : Hamami në Shkodër; Hamami në Lezhë; Hamami në Krujë; Hamami në Durrës; Hamami në Elbasan; Hamami në Skrapar (Stallinjë); Hamami në Gjirokastrë; Hamami në Delvinë.	16.10.2023	Në vijim të kërkesës Suaj në adresën elektronike të IKTK-së, më datë 03.10.2023 "MULTIMEDIA_Hamami i Durrësit_EU4Culture_Kube Studios", ju bëjmë me dije se: Pranë arkivit teknik të IKTK-së disponojmë dokumentacion historik e përshkrimor e planimetri për objektet pasuri kulturore hamamet si më poshtë vijon: • Hamami në Durrës (relacion dhe planimetri); • Hamami në Shkodër (relacion) • Hamami në Lezhë (relacion); • Hamami në Krujë (planimetri e pershkrim monumenti); • Hamami në Elbasan (relacion); • Hamami në Skrapar (Stallinjë) (pershkrim monumenti); • Hamami në Gjirokastrë (pershkrim monumenti, relacion). Sa më sipër, mbështetur në ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe ligjin Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, ju vendosim në dispozicion bashkëlidhur ne link kopje digjitale të dokumentacionit arkivor (relacione dhe dy planimetri) të këtyre objekteve. Gjithashtu, mbështetur në ligjin Nr.35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjerë të lidhura me to", lutemi të vendoset burimi (Arkivi teknik IKTK), kur të përdoret dokumenti. Gjithashtu, ju informojmë se për objektin "Hamami në Delvinë" nuk disponojmë materiale arkivore që mund t'ju përgjigjen kërkesës suaj. https://www.transferxl.com/download/00vB5TgzqjrmDDE	E plotë	Jo
2/ 1245	09.10.2023	Kërkesë për informacion për Muzeun Arkeologjik Durrës	11.10.2023	Në vijim të korrespondencës në lidhje me me restaurimin e Muzeut Arkeologjik në Durrës, administruar pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (këtu e në vijim ‘IKTK’), me Nr. 1245 Prot., datë 09.10.2023, Ju sqarojmë si më poshtë vijon:	E plotë	Jo

				Kur kanë nisur punimet për rikonstruksionin e Muzeut Arkeologjik Durrës? - <i>Punimet për restaurimin e këtij objekti kanë nisur në muajin Nëntor të viti 2022.</i> Cili ishte afati fillestar për përfundimin e këtyre punimeve? - <i>Afati i punimeve sipas grafikut të punimeve të miratuar në KKTKM ka qenë 11 muaj.</i> Sa është vlera e fondit për rikonstruksionin e Muzeut Arkeologjik Durrës? - <i>Vlera e Kontratës: 348,368,591 Lekë</i> Sa i përket pyetjeve 4, 5 dhe 6 të kërkesës, sjellim në vëmendje se këto çështje janë në kompetencë të Ministrisë së Kulturës. Për këtë arsye, ju duhet ti drejtoheni Ministrisë së Kulturës për të marrë informacionin e kërkuar. Cili është plani për restaurimin e tij, shembuj me foto, pamje të projektit të përfunduar, ose ilustrime të tjera të ngjashme. - <i>Bazuar ne Kreun IV “Kufizimi i të drejtës për informim”, neni 17, pika 1, gërma ‘c’ i Ligjit Nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, projekti është realizuar nga studio private dhe si i tillë ky informacion kufizohet nga e drejta e autorit.</i> Shenim: Objekti i Muzeut Arkeologjik të Durrësit nuk është monument kulture, sipas parashikimeve në Ligjin Nr. 27/2018 si dhe VKM Nr. 1125, datë 30.12.2020, dhe për këtë arsye nuk mund te supervizohet apo kolaudohet nga IKTK.		
3/ e- mail	09.10.2023	Kërkesë për informacion 'Kompleksi i Sahatit'	16.10.2023	Në vijim të kërkesës Suaj në adresën elektronike të IKTK-së, më datë 09.10.2023 "Kompleksi i Sahatit", mbështetur në ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe ligjin Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, ju vendosim në dispozicion bashkëlidhur ne link kopje digjitale të dokumentacionit arkivor për objektin e kompleksit të Kullës së Sahatit si më poshtë: Skeda e objektit me kod A.0.36 (ne kuadër të projektit të rikualifikimit në zonën urbane pranë qendrës së qytetit Vlorë - Hartimi i projektit urban, restaurimi i monumenteve te kulturës	E plotë	Jo

				në këtë zonë dhe rikonstruksioni i objekteve të tjerë, Vlorë, viti 2017, hartuar nga studio e arkitekturës "Atelier 4" e cila permban: 1. <i>Fletet grafike te projektit;</i> 2. <i>Raporti teknik;</i> 3. <i>Specifikimet teknike.</i> Gjithashtu, mbështetur në ligjin Nr.35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", lutemi të vendoset burimi (Arkivi teknik IKTK), kur të përdoret dokumenti https://www.transfexl.com/download/08jMNpc2S658X1		
4/ e-mail	09.10.2023	Kërkesë për matarialin arkivor të pesë manstireve në Luginën e Drinos-it	19.10.2023	Në vijim të kërkesës Suaj në adresen elektronike të IKTK-së, më datë 09.10.2023, lidhur me materiale arkivore për manastiret e Luginës së Drinos", si dhe ne vijim te komunikimit me ju, Ju bejme me dije se materiali arkivor i është derguar ne format elektronik CHëB - znj. Jora Kasapi më datë 16.05.2023, për objektet pasuri kulturore si më poshtë: 1. Manastiri i Shën Qirjakut dhe Julitës, Dhuvjan; 2. Manastiri i Shën Mërisë së Ravenës, Goranxi; 3. Manastiri i Ungjillëzimit, Vanistër; 4. Manastiri i Shpërfytyrimit, Mingul; 5. Manastiri Lindja e Shën Mërisë në Spile, Tranoshisht.	E plotë	Jo
e-mail	09.10.2023	Kerkese per informacion "Rehabilitimi i sheshit kryesor tek Varrezat e Dëshmorëve"	10.10.2023	Nga verifikimet e kryera ne regjistrin kombetar te pasurive kulturore, qe institucioni yne disponon dhe te cilat mund te aksesohen edhe online ne faqen zyrtare te IKTK-se, "Varrezat e Dëshmoreve" ne Tiranë, nuk rezultojne te jene pjese perberese e kesaj liste. Per kete arsye nuk mund te shprehem apo te japim nje vleresim mbi propozimin e derguar.	E plotë	Jo
email	11.10.2023	Kërkesë për informacion “Manastiri i Ardenices”		Në përgjigje të kërkesës suaj dërguar me postë elektronike datë 11.10.2023, administruar pranë Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore (IKTK) me Nr.1261 Prot, datë 11.10.2023, në të cilën kërkohet informacion mbi “Manastirin e Ardenicës”, Ju informojmë se: Manastiri i Shën Mërisë në Ardenicës është shpallur monument kulture i kategorisë së I-rë nga: 1. <i>Instituti i Shkencave me vendim Nr.586, datë.17.03.1948;</i> 2. <i>Rektorati i Universitetit Shtetëror të Tiranës me vendim Nr.6, datë.15.01.1963;</i> 3. <i>Ministria e Arsimit dhe Kulturës me vendim Nr.68/7 datë.30.05.1970;</i>	E Plotë	Jo

				<i>4.Ministria e Arsimit dhe Kulturës me vendim Nr.1886 datë.10.06.1973.</i> Nisur nga gjendja kritike strukturore e konakëve të këtij manastiri, në 2021 IKTK hartoi një projekt restaurimi të plot (projekti arkitektonik dhe ai i pikturës murale) për gjithë pjesët përbërëse të manastirit i cili u miratua në KKTKM me Vendim nr.526, datë11.08.2021. Ky projekt për mungesë fondesh nuk është zbatuar ende. Objekti pasuri kulturore, Manastirit i Shën Mërisë në Ardenicë është një ndër objektet e renditura në listën e riskut e cila përditësohet çdo fillim viti. Lista e riskut është organizuar në mënyrë të tillë ku janë renditur pasurit kulturore të vlerësuara në risk sipas një matrice vlerësimi të klasifikimit të rrezikshmërisë, ku të gjitha Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore në bashkërendim me IKTK vendosin prioritet e kërkesave për investime në këto objekte në mënyrë që të realizojnë restaurimin e tyre sa më parë të jetë e mundur për të mos i humbur këto pasuri kulturore dhe tejçimin e vlerave të pa diskutueshme që ato mbartin brezave të ardhshëm. Bazuar në listën e riskut, në fillim të viti 2023 është hartuar Fisha e investimit (vetëm për projektin arkitektonik) dhe i është dërguar Ministrisë së Kulturës si një nga objektet e trashëgimisë kulturore të renditura në PBA për investim në vitin 2024. Fondi i kërkuar është bazuar në preventivin e projektit të miratuar në KKTKM, me një shumë prej 5,745,000 lekë.		
email	16.10.2023	Kërkesë për Kishën e Shën Pjetrit në qytetin Mesjetar të Sardës	17.10.2023	Në përgjigje të kërkesës suaj, dokumentaciomi I kerkuar ju niset nepermjet linkut te meposhte https://www.filemail.com/d/ooldxdejegvtacyt	E plotë	Jo
email	01.11.2023	Kërkesë për informacion për Urën e Hoshteves, Zagori-Gjirokastër	08.11.2023	Në vijim të kërkesës Suaj në adresën elektronike të IKTK-së, më datë 01.11.2023 "Ura e Hoshtevës", ju bëjmë me dije se: Pranë arkivit teknik të IKTK-së disponojmë dokumentacion teknik dhe fotografik per objektin pasuri kulturore Ura e Hoshtevës, Zagori. Sa më sipër, mbështetur në ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe ligjin Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, ju vendosim në dispozicion bashkëlidhur ne link kopje digjitale të dokumentacionit arkivor te objektit. Gjithashtu, mbështetur në ligjin Nr.35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", lutemi të vendoset	E plotë	Jo

				burimi (Arkivi teknik IKTK), kur të përdoret dokumenti. https://www.transferxl.com/download/08vFDg0V7XzPCy		
email	02.11.2023	Kërkesë për informacion "Banesa e Hilmi Velagoshtit, lagjja Murat Çelebi", Berat	17.11.2023	Në vijim të kërkesës Suaj në adresën elektronike të IKTK-së, më datë 02.11.2023 "Kërkesë për dokumentacion arkivor", ju bëjmë me dije se: Pranë arkivit teknik të IKTK-së disponojmë dokumentacion arkivor për objektin "Banesa e Hilmi Velagoshti", Berat si me poshte: • Dokumentacion pershkrimor; • Skeda teknike viteve 1960-1965; • Foto historike me rezolucion të lartë (kemi përcaktuar për secilen foto vitin dhe autorin e fotos në një dokument të veçantë). Sa më sipër, mbështetur në ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat" dhe ligjin Nr. 119/ 2014 "Për të drejtën e informimit", ju vendosim në dispozicion bashkëlidhur në link kopje digjitale të dokumentave arkivore në ndihmë të studimit tuaj. Gjithashtu, mbështetur në ligjin Nr.35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", lutemi të vendoset burimi (Arkivi teknik IKTK), kur të përdoret dokumenti. https://www.filemail.com/d/joordejzxmsfzkg	E plotë	Jo
email	07.11.2023	Kërkesë për informacion për Kishën e Shën Mërisë në Ishullin e Maligradit, Prespë.	20.11.2023	Në vijim të kërkesës Suaj në adresën elektronike të IKTK-së, më datë 07.11.2023 "Pyetje për kishën e Shën Mërisë në ishullin e Maligradit", ju bëjmë me dije se: Pranë arkivit teknik të IKTK-së disponojmë dokumentacion grafik dhe fotografik për objektet pasuri kulturore të bashkisë Pustec që mund t'ju shërbejnë në studimin tuaj si me poshte: -KISHA E SHEN MARISE NE UJDHESEN E MALIGRADIT te Prespes pranë fshatit Pustec, Prespë e Madhe (një skedë teknike dhe foto historike); - KISHA E SHEN MITRIT Në FSHATIN BEZMISHT (vetëm foto historike); -KISHA E SHEN MERISE GOLLOMBOC (vetëm foto historike).	E Plotë	Jo

				Sa më sipër, mbështetur në ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe ligjin Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, ju vendosim në dispozicion bashkëlidhur ne link kopje digjitale të dokumentave arkivore qe disponojme per keto objekte. Gjithashtu, mbështetur në ligjin Nr.35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", lutemi të vendoset burimi (Arkivi teknik IKTK), kur të përdoret dokumenti https://www.transferxl.com/download/08vh5GcgT456VN		
email	07.11.2023	Informacion mbi "Kullat e Dervishaliut"	11.10.2023	Në vijim të kërkesës së z. Besmir Dervishaliaj deleguar nga ju në adresën elektronike të IKTK-së, më datë 07.11.2023 "<i>Kërkesë për Informacion Ministrisë të Kultures mbi programe per monumentin te kultures te k I-are Kullat e Dervishaliut (Dukat, Vlore)</i>", ju bëjmë me dije se: Pranë arkivit teknik të IKTK-së disponojmë dokumentacion arkivor për objektin pasuri kulturore "Kullat e Dervish Aliu", në fshatın Dukat, Vlorë si më poshtë: • Skeda teknike (plane, pamje skica etj) vitet 80-të shek XX; • Fletë grafike të ndërhyrjeve restauruese për objektin viti 1978; • Projekte restaurimi te viteve të fundit me të drejtë autori. Për sa më sipër, lutem të specifikohet nga i interesuari qëllimi i kërkesës, cilin dokument kerkon dhe në cilësinë e kujt e kerkon. Nëse është pronari i banesës të dërgoj një dokument hipotekor të shoqëruar me harte treguese.	E Plotë	Jo
email	15.11.2023	Kërkesë për dokumentacion arkivor ne lidhje me objektin "URA E UJËSJELLËSIT TË SOPOTIT MBI PËRROIN BUFANO", ne lagjen Dunavat, Gjirokaster.	21.11.2023	Në vijim të kërkesës Suaj në adresën elektronike të IKTK-së, më datë 15.11.2023 "Kërkesë për dokumentacion arkivor për objektin "URA E UJËSJELLËSIT TË SOPOTIT MBI PËRROIN BUFANO", mbështetur në ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe ligjin Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, Ju vendosim në dispozicion bashkëlidhur ne link kopje digjitale të dokumentacionit arkivor fotografik që disponojmë në	E plotë	Jo

				Arkivin Teknik për objektin pasuri kulturore "Ura e Ujesjellesit te Sopotit mbi përroin Bufano", Gjirokastrë. Ju informojmë se për këtë objekt nuk disponojmë dokumentacion grafik apo përshkrimor. Gjithashtu, mbështetur në ligjin Nr.35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", lutemi të vendoset burimi (Arkivi teknik IKTK), kur të përdoret dokumentacioni arkivor https://www.transferxl.com/download/08q0p0VKQKJ0z		
email	17.11.2023	Vënie në dispozicion kopje te vendimit kryesor te vitit 2016 per projektin "Kualifikim urban dhe restaurim i objekteve ne Q.H. te fshatrave Dhermi dhe Vuno".	20.11.2023	Ne pergjigje te kerkeses ardhur ne email, bashkengjitur gjeni vendimin nr. 269 date 13.12.2016  Vendim nr. 269 date 13.12.2016 (1).ç	E Plotë	Jo
email	04.12.2023	Kërkesë për informacion "BANESA E GALIP SINOIMERIT, LAGJA DUNAVAT, RR."BULE NAIPI" NR.8. në qytetin e Gjirokastrës	14.12.2023	Në vijim të kërkesës Suaj në adresën elektronike të IKTK-së, më datë 04.12.2023 "Kërkesë Kerkese per materiale "Banesa e Galip Sinoimerit", Gjirokastrë, mbështetur në ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat" dhe ligjin Nr. 119/ 2014 "Për të drejtën e informimit", Ju vendosim në dispozicion bashkëlidhur ne link per objektin pasuri kulturore te kerkuar materialin arkivor ne format elektronik si me poshtë: Dokumentacion grafik: skica, plane, pamje, vitet 70-të shek XX. https://www.transferxl.com/download/08jGTyKd2L9Nvn Mbështetur në ligjin Nr.35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", lutemi të vendoset burimi (Arkivi teknik IKTK), kur të përdoret dokumentacioni arkivor.	E Plotë	Jo
email	05.12.2023	Kerkese per informacion për nje ndertim pa leje jashte kriterëve perkatese ne zonen tampon ne Berat.		Ne vijim te emailit tuaj, referuar punimeve pa leje ne Lagjen 28 Nentori, Brenda Zones se Mbrojtur te Qendres Historike te qytetit te Beratit, Ju dergojme bashkelidhur	E Plotë	Jo

				shkresen drejtuar DRTK Berat ne lidhje me marrjen e masave dhe kthimin e situates ne gjendjen e meparshme duke zbatuar dispozitat ligjore te ligjit nr. 27/2018 "Per Trashegimine Kulturore dhe Muzete".  Kerkese per marrje masash.pdf		
email	12.12.2023	Kërkesë për informacion mbi Objektin Qibrie Ciu Lagja Dunavat Gjirokaster, Monumet Kulture Kategorja e Dyte.	12.12.2023	Në vijim të kërkesës Suaj në adresën elektronike të IKTK-së, më datë 12.12.2023, mbështetur në ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe ligjin Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, Ju vendosim në dispozicion bashkëlidhur ne link kopje digjitale të të gjithë dokumentacionit arkivor që disponojmë në Arkivin Teknik për objektin pasuri kulturore "Banesa e Qibrie Ciu", ne lagjen "Dunavat", Gjirokastër. https://www.transferxl.com/download/08jHJNb8LkQ3CY Gjithashtu, mbështetur në ligjin Nr.35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", lutemi të vendoset burimi (Arkivi teknik IKTK), kur të përdoret dokumentacioni arkivor.	E plotë	Jo
email	12.12.2023	"Banesa e Mehmet Peshtanit, lagjja Murat Çelebi, Berat". Per kete banese me nevojiten: 1. Materiali grafik (skica, rilevime dhe perpunimi grafik); 2. Materiali fotografik, me rezolucion te mire per botim (do t'ju lutesha, qe ne nje format eord te shenohet autori qe ka realizuar fotot dhe vitin kur ato jane fotografuar); dhe 3. Materiali pershkrimor (relacione teknike etj).	14.12.2023	Në vijim të kërkesës Suaj në adresën elektronike të IKTK-së, më datë 11.12.2023 "Kërkesë për dokumentacion arkivor", ju bëjmë me dije se: Pranë arkivit teknik të IKTK-së disponojmë vetem dokumentacion fotografik per objektin "Banesa e Mehmet Peshtani", "ne lagjen "Murat Çelebi" Berat. Sa më sipër, mbështetur në ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe ligjin Nr. 119/ 2014 “Për të drejtën e informimit”, ju vendosim në dispozicion bashkëlidhur ne link kopje digjitale të dokumentave arkivore në ndihmë te studimit tuaj si me poshte: • Foto historike me rezolucion te larte (viti 1969, autori i fotos Refik Veseli). https://www.transferxl.com/download/08Q5sGJzH2tBB Gjithashtu, Ju dergojme bashkelidhur edhe dokumentacionin hartografik lidhur me zonimin e	E plotë	Jo

				Qendrës Historike të qytetit Beratit, i cili daton para viteve '90-të shek. XX (nuk është i përcaktuar viti). https://www.transferxl.com/download/08jXbs8ksVJpq9 Mbështetur në ligjin Nr.35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", lutemi të vendoset burimi (Arkivi teknik IKTK), kur të përdoret dokumenti.		
email	18.12.2023	Dokumentacion arkivor mbi Kishën e Bënjës.	27.12.2023	Në vijim të kërkesës Suaj në adresën elektronike të IKTK-së, më datë 18.12.2023 për informacion dhe dokumentacion mbi "Kishën e Bënjës", mbështetur në ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat" dhe ligjin Nr. 119/ 2014 "Për të drejtën e informimit", Ju vendosim në dispozicion bashkëlidhur ne link materialin arkivor lidhur me kete pasuri kulturore si me poshtë: • Planimetri e objektit (viti 1982) • Relacion përshkrimor (viti 1983) Mbështetur në ligjin Nr.35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", lutemi të vendoset burimi (Arkivi teknik IKTK), kur të përdoret dokumentacioni arkivor. https://www.transferxl.com/download/08jZjr6QkDD0Hh	E Plotë	Jo
email	19.12.2023	Informacion mbi "Banesën e Zekatëve", Gjirokastrë.	27.12.2023	Në vijim të kërkesës Suaj në adresën elektronike të IKTK-së, më datë 19.12.2023 për informacion "Banesa e Zekatëve", Gjirokastrë, mbështetur në ligjin Nr.9154, datë 6.11.2003 "Për Arkivat" dhe ligjin Nr. 119/ 2014 "Për të drejtën e informimit", Ju vendosim në dispozicion bashkëlidhur ne link materialin arkivor lidhur me kete pasuri kulturore si me poshtë: • Planimetri te objektit (viti 1967). Mbështetur në ligjin Nr.35/2016 "Për të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to", lutemi të vendoset burimi (Arkivi teknik IKTK), kur të përdoret dokumentacioni arkivor. https://www.transferxl.com/download/086SqCzCjtz9m	E Plotë	Jo
